



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 maj 2015
Nr. ref.: VHK 794/15

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin nr. KI149/14, KI150/14 dhe KI151/14

Parashtrues

Liridon Aliu

**Kërkesë për vlerësimin kushtetues të punës të disa institucioneve të
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Liridon Aliu, kryetar i organizatës joqeveritare (OJQ) "Ngrite zërin dhe ti" (NZT), nga fshati Hajvali, komuna e Prishtinës. Ai nuk kishte sqaruar nëse kërkesën e ka parashtruar në emër të tij apo të OJQ-së që ai drejton.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë vendim të caktuar të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon nga Gjykata vlerësimin e punës së disa prej institucioneve të Kosovës, sidomos të atyre të rendit dhe të ligjit, të gjykatave si dhe të Kuvendit të Kosovës. Parashtruesi nuk ka theksuar shkeljen e ndonjë dispozite kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi tri kërkesa në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 30 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës së tij.
7. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI149/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Të njëjtën ditë, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi që kërkesat KI150/14 dhe KI151/14 të bashkohen me kërkesën KI149/14 dhe që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues për të dy rastet (KI150 dhe KI151/14) të jenë të njëjtë, ashtu siç ishte vendosur për kërkesën KI149/14.
9. Më 24 mars 2015, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 16 prill 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka paraqitur Gjykatës fakte konkrete lidhur me kërkesën, por udhëzon Gjykatën në një numër të madh ueb-faqesh dhe në ekstrakte gazetash të ilustruara me fotografi dhe shpreh gatishmërinë ta ndihmojë Gjykatën në gjetjen e fakteve për të cilat pretendon se janë objekt i ankimit.

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se institucionet e vendit, sidomos ato të ndjekjes, të rendit e të ligjit dhe gjykatat kanë dështuar në parandalimin dhe ndëshkimin e veprave korruptive, “hajnisë dhe vjedhjeve”, pra veprave penale. Ndërsa pohon se Kuvendi i Kosovës nxjerr ligje kundërkushtetuese e të panevojshme, duke iu referuar në veçanti Ligjit për parandalimin e pjesëmarrjes në luftëra të huaja, i cili në kohën e paraqitjes së kërkesës ishte në fazën e shqyrtimit.
13. Parashtruesi më tej pretendon se në Kosovë individë të caktuar janë arrestuar paligjshëm nga Policia e Kosovës. Parashtruesi nuk ka theksuar që atij drejtpërsëdrejti t’i jetë shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton:
“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.
16. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 32 par. 4 të Rregullores së punës në fuqi në kohën e kërkesës, i cili përcakton:

Rregulli 32

Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes

(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.

17. Siç është cekur më lart, parashtruesi nuk konteston asnjë akt specifik të ndonjë autoriteti publik, nuk përcakton asnjë shkelje të ndonjë të drejte kushtetuese ndaj tij, nuk precizon cila është baza e kontestit por, në mënyrë të përgjithësuar, nisur nga këndvështrimi i tij, kërkon vlerësimin abstrakt të kushtetutshmërisë së veprimeve apo të mosveprimeve të organeve dhe të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.
18. Gjykata përkujton se sistemi kushtetues juridik i Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që është modalitet i ankesave individuale që i mundësojnë cilitdo individ, i cili tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, që t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkeljet e tilla, edhe pse nuk e ka statusin e viktimës apo interesin e drejtpërdrejtë.

19. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e lartpërmendur nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet si kërkesë (Shih Rastin KI143/13, parashtrues i kërkesës *Nebih Sejdiu*, Vendimi për heqjen e kërkesës nga lista, i 24 prillit 2014; shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, rastin *Starodub kundër Ukrainës*, Nr. 5483/02, GJEDNJ, Vendimi i 7 qershorit 2005). Prandaj konsideron se kjo kërkesë nuk paraqet rast apo kontest dhe duhet të deklarohet e papranueshme dhe, në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, të hiqet nga lista.


PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 23 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 32 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 18 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën e parashtruar;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafin 4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani